



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.806 Prot.

Tiranë, më 23 .05. 2022

**V E N D I M**

**Nr. \_\_\_\_\_ , Datë \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / 2022**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 192 Regj, datë 27.10.2021, paraqitur nga ankuesi R.S (*në vijim ankuesi*), kundër Shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Tema” (*në vijim Shkolla*) dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Klos (*në vijim ZVAP Klos*), me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe për çdo shkak tjetër. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi R.S deklaron se është person me aftësi të kufizuara, me raport mjeko-ligjor që prej moshës foshnjore, me diagnozë paralizë spastike. Ai shpjegon se është me arsim të lartë dhe është diplomuar dhe licensuar në Degën Gjuhë Shqipe-Letërsi, me Master Profesional Cikli i Lartë Bazë.

Pas mbarimit të shkollës së lartë ka bërë kërkesë për punë, por Zyra Vendore e Arsimit Mat, nuk ia realizoi kërkesën duke e lënë 5 (pesë) vite pa punë, nga viti 2012 deri në vitin 2018. Në vitin 2018 ankuesi deklaron se është caktuar mësues ndihmës me kontratë në fshatin Kurdari, Shkolla “Ibrahim Tema” ku ka punuar nga periudha 17.09.2018 deri në 16.06.2021.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Ankuesi pretendon se është pezulluar nga puna pa asnjë motivacion, duke u zëvendësuar me një mësuese, e cila ka punuar disa vite në shkollën e mesme të Bashkisë Klos. Sipas tij, kjo mësuese pasi kundërshtoi vendin e saj të punës, e emëruan mësuese ndihmëse në vendin që mbante ankuesi dhe se ajo gëzon shëndet të plotë, pra nuk është person me aftësi të kufizuar.

Ankuesi shprehet se drejtori i shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Tema” Kurdari gojarisht i ka thënë se “nuk ka vend pune për ty”, ndërsa pas shqetësimit të ngritur lidhur me problemin e tij, pranë ZVAP Klos, ai shprehet se është kontaktuar nga kjo zyrë dhe i është thënë se nuk është e nevojshme që çështja të bëhet publike pasi çdo gjë do të rregullohet. Ankuesi vazhdon të jetë i papunë dhe nuk zbatohet raporti 1 me 25 persona për personat me aftësi të kufizuar në marrëdhëniet e punës.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri që t’i jepet e drejta e përcaktuar me ligj, duke u rikthyer në punë dhe duke u emëruar mësues definitiv, si dhe dëmshpërblimin për 5 vitet që ka qenë pa punë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtëpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1490/1 prot, datë 08.11.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shkolla dhe ZVAP Klos, në cilësinë e subjekteve kundër të cileve është paraqitur ankesa.

1.1 Me shkresën nr.639/1 prot., datë 18.11.2021 ZVAP Klos dhe Shkolla kanë kthyer përgjigje në një shkresë të përbashkët, duke parashtruar se:

R.S ka punuar si mësues ndihmës me kontratë pune me afat të caktuar në Shkollën “Ibrahim Tema”, Kurdari, për periudhat e mëposhtme:

- 17.09.2018-08.06.2020 – marrëdhëniet e punës kanë përfunduar me mbarimin e kontratës;
- 14.09.2020 – 16.06.2021 – marrëdhëniet e punës kanë përfunduar me mbarimin e kontratës.

Sa i përket pretendimit se mësuesi është pezulluar nga puna pa asnjë motivacion dhe zëvendësuar me një mësues tjetër, kjo nuk qendron, pasi të dy këta mësues kanë punuar njëkohësisht në shkollë dhe mësuesja në fjalë nuk ka zëvendësuar z.S. Mësuesja në fjalë ka filluar punë në shkollën “Ibrahim Tema” pas shkurtimeve të vendit të punës në shkollën ku punonte më parë. Gjithashtu R.S nuk është pezulluar nga puna, por i ka përfunduar kontrata e lidhur me institucionin arsimor. Z. S gjatë gjithë periudhës që ka punuar në shkollën “Ibrahim Tema”, ka qenë i punësuar me kontratë me afat të caktuar dhe jo me emërim.

Sa i përket pretendimit se drejtori i shkollës i ka thënë gojarisht se “*nuk ka vend pune për ty*” dhe se ZVAP Klos i ka thënë “*mos ta bëjë publike se çdo gjë do rregullohet*”, këto shprehje nuk qëndrojnë, pasi kjo mënyrë komunikimi me qytetarët punëmarrës apo ish punëmarrës, në këto institucione nuk ka ekzistuar në asnjë moment dhe për asnjë rast, edhe pse gjithmonë ka ekzistuar vullneti dhe dëshira për të ndihmuar qytetarin.

ZVAP Klos dhe shkolla “Ibrahim Tema”, në përgjigjen e tyre theksojnë se z.S nuk ka qenë i emëruar në shkollën 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, por ka qenë i punësuar me kontratë me afat të caktuar dhe marrëdhëniet e punës janë zgjidhur me përfundimin e afatit të parashikuar në kontratë.

Vendi i punës i mbajtur nga ankuesi nuk është plotësuar me mësues tjetër. Arsyet që ankuesi nuk mund të sistemohej në të njëjtin vend pune ose në një vend të ngjashëm me të është mungesa e ngarkesës mësimore për profilin e mësuesit ndihmës ose gjuhës shqipe dhe letërsi.

Subjektet informojnë se, numri total i mësuesve ndihmës në ZVA Klos është 16, ndërsa numri i nxënësve me aftësi të kufizuara është 23 dhe shpërndarja e tyre është si më poshtë:

Nr.	ZVAP	Institucioni arsimor	Nr. i mësuesve ndihmës
1	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos	4
2	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari	1
3	Klos	SHMB Xibër	3

4	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ali Alla”, Rripë	1
5	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ramiz kadiu”, Bejnë	2
6	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Gurrë e Vogël”	2
7	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ramazan Velçani”, Cerujë	2
8	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Rexhep Shira”, Fullqet	1

Nr.	ZVAP	Institucioni arsimor	Nr. i nxënësve me aftësi të kufizuara
1	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos	7
2	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari	2
3	Klos	SHMB Xibër	5
4	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ali Alla”, Rripë	1
5	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ramiz kadiu”, Bejnë	2
6	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Gurrë e Vogël”	2
7	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Ramazan Velçani”, Cerujë	2
8	Klos	Shkolla 9-vjeçare “Rexhep Shira”, Fullqet	2

Në ZVAP Klos janë punësuar si definitiv 12 mësues.

Sa i përket kërkesës së z. S për emërimin definitiv, sipas udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021, që një mësues të emërohet definitiv në një institucion arsimor duhet t’i nënshtrohet procedurave të Portalit Mësues për Shqipërinë, përndryshe ai mund të punësohet vetëm me kontratë pune me afat të caktuar, pasi të ketë shteruar lista e kandidatëve të Portalit.

Në ZVA Klos nuk ka mbërritur asnjë kërkesë ose ankesë në lidhje me punësimin e ankuesit gjatë periudhës 20.05.2019 – 17.11.2021.

2. Me shkresën nr.1738 prot datë 21.12.2021, ankuesi ka paraqitur kundërshtimet e tij duke parashtruar ndër të tjera se:

Ankuesi ishte caktuar i pari mësues ndihmës me kontratë me afat të përcaktuar. Mësuesja që e ka zëvendësuar ka punuar disa vite në shkollën e mesme Klos dhe pasi kishte refuzuar vendin e punës

e kanë emëruar mësuese ndihmëse në fshatin Kurdari. Ankuesi ka punuar mësues ndihmës në ciklin e ulët dhe mësuesja në fjalë në ciklin e lartë.

Ankuesi pretendon se pezulluar nga puna pa asnjë motivacion dhe në vendin e tij të punës është emëruar mësuesja duke punuar me nxënës me aftësi të kufizuar. Drejtori i shkollës e kishte informuar verbalisht se nuk kishte vend pune për të. Ankuesi pretendon se është diskriminuar dy herë, ku herën e parë e kanë lënë 5 vite pa punë dhe herën e dytë e pezulluan pa motivacion.

3. Me shkresën nr.1490/4 prot datë 17.12.2021, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga ZVAP Klos dhe Shkolla “Ibrahim Tema”, Kurdari, në lidhje me mësuesin tjetër ndihmës të punësuar në këtë shkollë.

3.1 Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.699/1 prot datë 20.12.2021, ZVAP Klos, informoi Komisionerin se:

Në shkollën 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari është e punësuar vetëm një mësuese ndihmëse. Ajo ka përfunduar studimet e larta në profilin “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, si dhe ka kryer studimet Master Profesional në profilin “Pedagogji e specializuar sociale”. Kjo mësuese është e punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar. Ajo është punësuar në shkollën 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari, si mësuese ndihmëse në datën 09.11.2018.

4. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>3</sup>, të ndryshuar dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 21.01.2022. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 22.01.2022, me pjesmarrjen e të dy palëve, ankuesit i cili ishte personalisht prezent dhe ZVAP Klos, përfaqësuar nga z. E.B, sipas autorizimit nr.27 prot., datë 20.01.2022, lëshuar nga Drejtori i ZVAP Klos dhe Shkolla “Ibrahim Tema”, Kurdari, përfaqësuar nga drejtori z. Arben Allamani.

Gjatë seancës dëgjimore, palët mbajtën të njëjtin qëndrim që kishin përcjellë pranë Komisionerit nëpërmjet komunikimit shkresor.

Ndër të tjera gjatë seancës dëgjimore, ankuesi deklaroi se ishte futur në Portalin Mësues për Shqipërinë vetëm në vitin 2015 dhe nuk ishte bërë më pjesë e këtij procesi.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ZVAP Klos, theksoi se, rekrutimi i mësuesve realizohet vetëm nëpërmjet Portalit dhe ata nuk kanë patur mundësi që të punësojnë ankuesin, sepse të gjithë mësuesit janë marrë nga Portali. Gjithashtu, ZVAP Klos, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në seancë theksoi, se ndërprerja e kontratës së punës me ankuesin ka ndodhur për shkak se kishte përfunduar afati dhe një gjë e tillë ishte bërë edhe për mësues të tjerë të cilit kanë qenë me kontratë me afat sikurse ankuesi. Pavarësisht vullnetit të tyre për ta sistemuar në punë ankuesin, kjo gjë nuk ishte e

<sup>3</sup> Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

mundur për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore. Përfaqësuesi i ZVAP Klos informoi se ankuesi është i vetmi mësues me aftësi të kufizuara në juridiksionin e kësaj zyre arsimore.

5. Në vijim të seancës dëgjimore me shkresën nr. 283 prot., datë 08.02.2022, Komisioneri, kërkoi informacion nga ana e ZVAP Klos dhe Shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari, në lidhje me ngarkesën mësimore të ankuesit me mësueses tjetër ndihmëse dhe numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë marrë mbështetje me mësues ndihmës gjatë 3 viteve të fundit.

Me anë të shkresës së sipërcituar dhe mbështetur në nenin 33, pika 9 të LMD-së, ku parashikohet se: “ 9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.”, Komisioneri i’u drejtua ZVAP Klos dhe Shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari, mbi mundësinë e arritjes së një marrëveshje pajtimi midis palëve, nëpërmjet sistemimit të ankuesit në një vend pune, të pranuar nga ana e tij.

5.1 Në përgjigje të shkresës së mësipërme të Komisionerit, me shkresën nr.68/1 prot., datë 18.02.2022, ZVAP Klos, informoi ndër të tjera se:

Mësuesja Z.S. dhe mësuesi R.S kanë patur ngarkesë të plotë mësimore prej 20 orësh, për vitet shkollore 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, ndërsa për vitin shkollor 2021-2022 në shkollën 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, ka patur ngarkesë mësimore vetëm për 1 mësues.

ZVA Klos informon se kjo zyrë arsimore është krijuar si institucion në datën 20.05.2019 ndërsa punësimi i mësueses Z.S. është bërë në datën 09.11.2018. Për këtë arsye ata nuk disponojnë procedurat e punësimit dhe kontratën e punës të lidhur me këtë mësuese, dhe për këtë informacion Komisioneri duhet t’i drejtohet ZVAP Mat. ZVAP Klos vendosi në dispozicion organikën e shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, për vitet shkollore 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022. ZVAP Klos informon se, në tabelën e organikës në kolonën “Status V/K” nënkupton V (Vendim/kontratë me afat të pacaktuar) dhe K (kontratë me afat të caktuar) dhe në këtë mënyrë përcaktohet nëse mësuesi është i emëruar ose me kontratë me afat të caktuar.

Mësuesit e tjerë ndihmës, të cilët janë larguar nga puna për shkak të rënies së ngarkesës mësimore kanë qenë me kontratë me afat dhe sipas nenit 149, pika 1 të Kodit të Punës, “Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake”. Pra, kontratat e tyre të punës kanë përfunduar me përfundimin e afatit të caktuar në kontratën e punës.

ZVAP Klos informon se, për vitin shkollor 2019-2020 në shkollat e ZVAP Klos kanë qenë 21 nxënës me aftësi të kufizuara dhe në vitin shkollor 2020-2021 kanë qenë 27 nxënës me aftësi të kufizuara që janë trajtuar me mësues ndihmës. Për vitin shkollor 2018-2019, ZVAP Klos, referon se Komisioneri duhet t’i drejtohet ZVAP Mat për marrjen e informacionit.

ZVAP Klos, nuk mbajti asnjë qëndrim në lidhje me kërkesën për arritjen e një marrëveshje me ankuesin të parashtruar nga Komisioneri.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi R.S ka përfunduar studimet e larta në profilin “Gjuhë shqipe-letërsi” dhe është pajisur me Diplomë të Nivelit të Parë me Nr.246, datë 30.09.2010, lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ankuesi ka përfituar Diplomën “Master Profesional” në “Mësuesi”, në ciklin e lartë të arsimit bazë në “Gjuhë Shqipe e Letërsi”, me nr.36, datë 22.07.2011, lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ankuesi është pajisur me Licensën “Për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilin “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”, me nr.1506001037, datë 28.12.2015, lëshuar nga Agjencia Kombetare e Provimeve.

Ankuesi është diagnostifikuar me “*paralizë spastike cerebrale*” dhe me vendimin nr.9405, datë 29.06.2021 të KMCAP Niveli i Parë Neurologji-N/Kirurgji, pranë Shërbimit Social Shtetëror, ka vlerësuar ankuesin si person me aftësi të kufizuara i grupit të dytë.

Nga aktet e administruara, rezulton se, ankuesi ka punuar mësues ndihmës pranë Shkollës “Ibrahim Tema”, Kurdari për periudhën 17.09.2018-08.06.2020 dhe 14.09.2020-16.06.2021, fakt ky që rezulton i pasqyruar në librezën e punës. Gjatë kësaj periudhe ankuesi ka nënshkruar disa kontrata individuale pune. Fillimisht, është nënshkruar kontrata individuale e punës me afat të caktuar me nr. 98 prot., datë 17.09.2018 me Zyrën Arsimore Mat për periudhën 17.09.2018-17.09.2019 midis ankuesit dhe Zyrës Arsimore Mat dhe më pas janë nënshkruar disa kontrata me afat të përcaktuar midis ankuesit dhe ZVAP Klos dhe konkretisht: kontrata individuale e punës me afat të përcaktuar nr.9/1 prot., datë 19.09.2019 për periudhën 19.09.2019 deri në 20.12.2019, nr.9/2 prot., datë 13.01.2020, për periudhën 13.01.2020-31.03.2020, nr.9/3 prot., datë 01.04.2020, për periudhën 01.04.2020-08.08.2020, nr. 78/1 prot., datë 14.09.2020, për periudhën 14.09.2020-16.06.2021.

Me shkresën nr.99 prot., datë 04.06.2021, të drejtorit të shkollës, ankuesi është njoftuar se duhet të paraqitet për takim në datën 08.06.2021, sipas parashikimeve të nenit 144/1 të Kodit të Punës. Palët janë takuar në datën 04.06.2021 dhe jo në datën e përcaktuar në njoftim, fakt ky që rezulton i provuar bazuar në procesverbalin me nr.99 prot datë 04.06.2021, i nënshkruar nga ankuesi dhe drejtori i shkollës. Ndërsa në procesvebal referohet se takimi kryhet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në pjesën e parashtrimeve nga ana e punëmarrësit, ankuesi ka vendosur shënimin “*Jam dakort me kontratën*”.

Me vendimin nr.35, datë 08.06.2021 “Për zgjidhjen e marrëdhënies së punës”, të drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari, është vendosur zgjidhja e marrëdhënies së punës me ankuesin nga pozicioni i punës mësues në profilin “mësues ndihmës”, për shkak mbarimit të kontratës së punës.

Ankuesi i është drejtuar Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe çdo shkak tjetër dhe se nuk respektohet raporti 1 me 25 persona në marrëdhëniet e punës. Ankuesi kërkon që të emërohet si mësues definitiv, pra me kontratë me afat të pacaktuar.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i këtij ligji si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c, përcakton se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”.

Bazuar në pikën 5, germa “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, parashikohet se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar



ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;

- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës. Nëse konstatohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, atëherë do të vijohet me analizën, nëse ky trajtim të cilit i është nënshtruar ankuesi ka ardhur apo jo si rezultat i shkaqeve të pretenduara, të cilat duhet gjithashtu të gëzojnë mbrojtje nga ligji. Në rast se nuk konstatohet ndonjë trajtim i padrejtë dhe i pafavorshëm, Komisioneri nuk do të vijojë me pjesën e dytë të analizës.

Në nenin 149, pika 1 dhe 3, të Kodit të Punës, parashikohet :“1. Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake” .....3. Në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të caktuar, përpara përfundimit të afatit, zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 144 të këtij Kodi.”

Rezultoi e provuar se ankuesi ka qenë i punësuar si mësues ndihmës në profilin “mësues ndihmës” pranë shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Tema”, Kurdari, institucion i arsimit parauniversitar në juridiksionin e ZVAP Klos, me kontratë punë me afat të përcaktuar. Sipas kontratës afati i përfundimit të marrëdhënieve të punës ka qenë data 16.6.2021. Komisioneri konstaton se drejtori i shkollës ka zgjidhur marrëdhëniet e punës me ankuesin në datën 08.06.2021, pra 8 ditë përpara datës së përcaktuar në kontratën individuale të punës.

Komisioneri konstaton se, nuk jemi përpara situatës së “pezullimit nga detyra”, sikurse pretendon ankuesi. Marrëdhënia e punës midis ankuesit si mësues ndihmës dhe shkollës “Ibrahim Tema” Kurdari ka përfunduar si pasojë e përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën individuale të punës së nënshkruar midis palëve. Respektimi i procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës sipas nenit 144 të K.Punës nuk janë objekt shqyrtimi nga ana e Komisionerit.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe rrethanave të konstatuara, bazuar në provat shkresore dhe deklaratimet e palëve gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi me këtë pretendim i referohet faktit se atij nuk i është mundësuar vazhdimi i marrëdhënieve të punës, marrëdhënie e cila pavarësisht se ka qenë e rregulluar me kontrata të njëpasnjëshme pune me afat të përcaktuar, ka zgjatur për një periudhë nga pothuajse tre vjeçare me disa shkëputje të vogla disa mujore. Bazuar në vazhdueshmërinë e marrëdhënies së punës, ankuesi ka patur pritshmërinë e vazhdimësisë dhe sistemimit të tij si mësues definitiv, duke u punësuar me kontratë me afat të pacaktuar.

Nga aktet e administruara nuk rezultoi e provuar se ankuesi është zëvendësuar nga një mësuese tjetër, sikurse pretendoi. Rezulton se, në shkollë kanë punuar njëkohësisht dy mësues ndihmës ankuesi dhe mësuese Z.S. Bazuar në librezën e punës të depozituar nga ZVAP Klos, mësuese S.Z ka filluar punë pranë shkollës në datën 9.11.2018. Pra, ankuesi nuk është zëvendësuar nga mësuesja Z.S, pasi ajo ka qenë e punësuar më parë në këtë shkollë. Rezulton se mësuese Z.S ka përfunduar studimet e larta në profilin “Gjuhë shqipe dhe Letërsi”, ka kryer studimet Master Profesional në profilin “Pedagogji e specializuar sociale”, si dhe ka fituar kategorinë e II “Mësues Specialist” për lëndën “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” (AMU).

Konstatohet se, mësuese Z.S., ndryshe nga ankuesi i cili ka qenë i punësuar me kontratë me afat të përcaktuar, figuron e punësuar si mësuese definitive, pra me kontratë me afat të pacaktuar. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është në kushte të ngjashme me mësuesen Z.S, e cila vazhdon marrëdhënien e punës si mësuese ndihmëse, pasi ajo është e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, ndërsa ankuesi ka qenë i punësuar me kontratë me afat të përcaktuar.

Në thelb të diskriminimit është trajtimi diferencues, i padrejtë dhe i pabarabartë, i dy situatave të njëjta ose të ngjashme. Sa më sipër, rezulton se ankuesi nuk është në kushte të njëjta ose të ngjashme me mësuesen Z.S.

Referuar të dhënave të administruara, rezulton se, gjatë 3 viteve të fundit numri i mësuesve ndihmës të punësuar në shkollën “Ibrahim Tema” Tema është si vijon: për vitin shkollor 2019-2020, 3 mësues ndihmës (ankuesi, Z.S dhe A.H); për vitin shkollor 2020-2021, 2 mësues ndihmës (ankuesi dhe Z.S); ndërsa për vitin shkollor 2021-2022 1 mësues ndihmës (Z.S).

Ndërsa për sa i përket numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët kanë ndjekur arsimin në një nga shkollat e ZVAP Klos, të dhënat paraqiten si vijon: për vitin shkollor 2019-2020, 21 nxënës me aftësi të kufizuara, për vitin shkollor 2020-2021, 27 nxënës me aftësi të kufizuara, ndërsa aktualisht gjatë vitit shkollor 2021-2022 ndjekin shkollën 23 nxënës me aftësi të kufizuara. Aktualisht, për vitin shkollor 2021-2022, në shkollën “Ibrahim Tema” Kurdari, ndjekin shkollën 2 nxënës me aftësi të kufizuara, të cilët mbështeten nga 1 mësues ndihmës dhe konkretisht nga mësuese Z.S.

Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019 *“Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”*, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në pikën 4, të Kreut I, parashikon : *“Një mësues ndihmës mund të punojë me 2 deri në 3 nxënës me aftësi të kufizuara brenda të njëjtin institucion arsimor, sipas Rekomandimit të Komisionit Miltidisiplinar të ngritur pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP-ve), bazuar në nivelin e vështirësisë dhe nevojës për mbështetje që paraqet nxënësi.”*

Komisioneri konstaton se, numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin në shkollën “Ibrahim Tema”, Kurdari gjatë vitit shkollor 2021-2022 dhe përcaktimi i ngarkesës së punës së një mësuesi ndihmës, sipas udhëzimit të sipërcituar, nuk ka mundur vazhdimin e marrëdhënies së

punës së ankuesit si mësues ndihmës, pranë kësaj shkolle. Ngarkesa mësimore aktuale (2 nxënës me aftësi të kufizuara) mbulohet sipas udhëzimit të sipërcituar dhe i takon mësueses Z.S, e cila është mësuese definitive, e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, në raport me ankuesin, i cili ka qenë i punësuar me kontratë me afat të përcaktuar.

Ankuesi pretendon se ai duhet të ishte punësuar si mësues definitiv, me kontratë me afat të pacaktuar.

E drejta për punës, është një e drejtë themelore e njeriut e sanksionuar nga Kushtetuta e RSH, në nenin 49, ku sanksionohet se: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.”*

E drejta për punë nuk duhet kuptuar si një e drejtë absolute dhe e pakushtëzuar për të siguruar punë.

Punësimi i mësuesve në një institucion publik të arsimit parauniversitar rregullohet në bazë të udhëzimit të MASR nr. 12, datë 10.06.2021 *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar dhe e pranuar nga vetë ankuesi se ai nuk është bërë pjesë e Portalit “Mësues për Shqipërinë”. Ai është bërë pjesë e këtij Portali vetëm në vitin 2015, por nuk është përfshirë në vitet pasardhëse. Ankuesi pretendon se, ai duhet të ishte punësuar si mësues definitiv dhe se nuk është respektuar detyrimi për të punësuar 1 (një) person me aftësi të kufizuara në 24 punëmarrës.

Udhëzimi nr.12/2021, i MASR, i cili rregullon procedurat e pranimit dhe emërimit të mësuesve në një vend të lirë pune në një institucion publik të arsimit parauniversitar, vendos detyrimin për të gjithë personat e interesuar të cilët duan të punësohen si mësues në një institucion publik të arsimit parauniversitar, të regjistrohen dhe të marrin pjesë në Portalin Mësues për Shqipërinë. Sipas këtij udhëzimi, emërimi si mësues definitiv, bëhet vetëm nëpërmjet procedurave të Portalit “Mësues për Shqipërinë”. Për sa kohë që ankuesi nuk është pjesë e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, ai nuk mund të pretendojë se duhet të ishte emësuar si mësues definitiv.

Komisioneri arrin në konkluzionin se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Shkollës 9-vjecare “Ibrahim Tema”, Kurdari dhe ZVAP Klos. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Një nga pretendimet e paraqitura nga ankuesi është edhe pretendimi për diskriminim për shkak se ankuesi nuk është punësuar si mësues, që prej vitit 2011, kur ka paraqitur kërkesë për punësim pranë ZVA-së, duke e lënë të papunë për rreth 5 vjet, deri në 2018 kur është emëruar si mësues ndihmës me kontratë pune me afat të caktuar.

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh”, të LMD, ku përeëktohet se: “ 4. Ankesa nuk pranohet nëse: dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, kjo pjesë e ankesës nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri pasi është tej afateve ligjore të parashikuara nga LMD dhe për rrjedhojë nuk i është nënshtruar proëedurave të shqyrtimit të parashikuara sipas këtij ligji.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim “për çdo shkak tjetër”, Komisioneri thekson se, neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit se është diskriminuar “për çdo shkak tjetër” pa identifikuar asnjë shkak konkret, i cili më pas të vlerësohej nga ana e Komisionerit nëse përbën ose jo një shkak që gëzon mbrojtje, nuk është i bazuar në LMD.

Bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... b) .....  
është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimi për diskriminim “për çdo shkak tjetër”, nuk mund të pranohet pasi është i papajtueshme me dispozitat e LMD dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtim.

Me ligjin nr. 108/2012, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” (KDPAK). KDPAK, sanksionon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të punuar. Në nenin 27 të KDPA sanksionohet se : “1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të punuar, në baza të barabarta me të tjerët; kjo përfshin të drejtën për të pasur mundësinë për të fituar jetesën, duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe ambientin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Shtetet palë duhet të mbrojnë dhe promovojnë realizimin e së drejtës për punë, përfshirë dhe ata që e fitojnë aftësinë e kufizuar gjatë punësimit, duke marrë

*hapat e duhur, përfshirë nëpërmjet legjislacionit, ndër të tjera: ..... g) Për të punësuar personat me aftësi të kufizuara në sektorin publik;*

*Në frymën e KDPAK është miratuar ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Në nenin 5, pika 2, germa “c”, të këtij ligji parashikohet: “..... Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: .....c) në një treg gjithëpërfshirës të punësimit;.....”*

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, është faktor kyç për përfshirjen sociale dhe integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara, sikurse ankuesi R.S, janë ndër grupet e disavantazhuara në tregun e punës.

*Në nenin 3, pika 4, germa “c”, të ligjit nr.15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, përcaktohet se: “4. “Grupe të veçanta” janë punëkërkues të disavantazhuar në tregun e punës, si:..... c) persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse; ...”*

*Në nenin 11, të LMD, parashikohet se : “Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.”*

Nga informacioni i dhënë nga ZVAP Klos gjatë seancës dëgjimore, rezulton se ankuesi është i vetmi mësues me aftësi të kufizuara i punësuar në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar në juridiksionin e kësaj zyre arsimore.

Sa më sipër, Komisioneri thekson nevojën për marrjen e masave në përputhje me parashikimet ligjore, për të siguruar punësimin e ankuesit, i cili është një person me aftësi të kufizuara.

Komisioneri evidenton nevojën për një qëndrim sa më proaktiv, për të nxitur dhe për të promovuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore publike

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit R.S, në të drejtën për punësim, për shkak të *aftësisë së kufizuar*, nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Klos dhe Shkolla 9-vjeçare

“Ibrahim Tema”, Kurdari.

2. Komisioneri rekomandon Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Klos, që të asistojë ankuesin, me pëlqimin e tij, për të kryer të gjitha procedurat e nevojshme për të marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” për vitin 2022.
3. Komisioneri rekomandon Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Klos, që të vlerësojë me prioritet mundësinë e punësimit të ankuesit, në një pozicion pune të përshtatshëm me kushtet e tij.
4. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Klos, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
5. Mospranimin për shqyrtim të pretendimit për diskriminim lidhur me mospunësimin e ankuesit si mësues gjatë periudhës 2011-2018, si dhe pretendimin për diskriminim për shkak “*çdo shkak tjetër*”, pasi nuk plotësojnë kriteret ligjore të parashikuara nga ligji nr.10221/2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar, për marrjen e tyre në shqyrtim.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Konceptoi: K.Keta, Inspektore DHA  
Rishikoi: E.Shyti, Inspektore DHA  
Konfirmoi: V. Bushati, Drejtore DHA  
Datë: 04/05/2022